

2. Maznita
2. Minoralli
01.10.2010

MINISTRI	DI	PROJEKTE
Nr.	5417	Prot.
Data	1	10 2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 776, datë 24.9.2010

P Ë R

**CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT TË KRYETARIT
DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES
TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr.10233, datë 11.2.2010, "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave


V E N D O S I:

1. Kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil të shpërblehen, përkatësisht, në masën 30% dhe 20%, të pagës së sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se një herë në muaj.
2. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga mbledhja e parë e këshillit drejtues.

3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT**



SOKOL OLLASHI

NR.PROT.3614/1
DATË 30.9.2010

PRESIDENCËS
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT
MINISTRISË SË FINANCAVE
AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA
Sekretari i Përgjithshëm

The image shows a circular official stamp of the Civil Aviation Authority of Albania. The text around the perimeter of the stamp reads "PRESIDENCËS MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT" at the top and "AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE" at the bottom. In the center of the stamp, there is a handwritten signature in black ink, which appears to be "Gjergj Lezhja".